

LIGJ
Nr. 27/2016

PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit nëpërmjet përcaktimit të kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit të kimikateve, përdorimit të kimikateve në artikuj, importit dhe eksportit të kimikateve të caktuara.
2. Të sigurojë lëvizjen e lirë të kimikateve dhe mallrave të tjera, si dhe të rrisë konkurrencën dhe inovacionin.
3. Të promovojë metodat alternative për vlerësimin e rreziqeve të kimikateve.
4. Të sigurojë që risqet nga substancat e rrezikshme që shkaktojnë shqetësim shumë të lartë (SVHC) janë kontrolluar në mënyrën e duhur dhe që këto substanca zëvendësohen në mënyrë progresive nga substanca më pak të rrezikshme ose zbatohen teknologji ku alternativat e përshtatshme të zëvendësimit janë ekonomikisht dhe teknikisht në dispozicion.
5. Të harmonizojë legjislacionin mbi kimikatet në Republikën e Shqipërisë me Sistemin e Harmonizuar Global për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve (GHS).
6. Të krijojë një sistem të detyrueshëm për klasifikimin, etiketimin, paketimin dhe Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet (MSDS).
7. Të zbatojë Konventën e Roterdamit në të cilën Shqipëria është palë.
8. Të krijojë dhe të mirëmbajë regjistrin e kimikateve që vendosen në tregun e brendshëm ose prodhohen për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë.
9. Të sigurojë depozitimin dhe ruajtjen e sigurt të kimikateve të vendosura në treg, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e këtij ligji.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka për objekt:

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

Rregulloren (KE) 1907/2006 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 18 dhjetor 2006, "Mbi regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Europiane të Kimikateve, e cila amendon direktivën 1999/45/KE, shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (KE) nr.1488/94, si dhe direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KEE dhe 2000/21/KE", e ndryshuar", numri CELEX 32006R1907, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 396, datë 30. 12. 2006, faqe 1 – 848.

Rregulloren (KE) 1272/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, "Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, e cila amendon dhe shfuqizon direktivat 67/548/KEE dhe 1999/45/KE dhe amendon Rregulloren (KE) 1907/2006", të ndryshuar", numri CELEX 32008R1272, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 353, datë 31. 12. 2008, faqe 1 – 1355.

1. Përcaktimin e detyrimeve ndaj prodhuesve, importuesve dhe përdoruesve për të klasifikuar kimikatet që vendosin në treg dhe për të siguruar Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet.

2. Përcaktimin e detyrimeve ndaj të gjithë furnizuesve për etiketimin dhe paketimin e kimikateve.

3. Përcaktimin e detyrimeve ndaj eksportuesve dhe importuesve të kimikateve, që janë subjekt i dispozitave të dhënies së pëlqimit paraprak të importit dhe njoftimit të eksportit.

4. Rregullimin e prodhimit, vendosjes në treg, përdorimit dhe eksportit të kimikateve të rrezikshme.

5. Përcaktimin e detyrimeve e të procedurave për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve që vendosen në tregun e brendshëm ose që prodhohen për t'u eksportuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Parimi i parandalimit

Dispozitat e këtij ligji mbështeten në parimin e parandalimit, sipas të cilit prodhuesit, importuesit ose përdoruesit profesionalë të kimikateve sigurojnë se prodhojnë, vendosin në treg apo përdorin kimikatet në mënyra të tilla, që ato të mos ndikojnë negativisht në shëndetin e njerëzve, duke mbajtur parasysh sidomos shëndetin e grupeve më të ndjeshme të popullsisë, ose në mjedis.

Neni 4

Zbatimi dhe përjashtime

1. Ky ligj zbatohet, pavarësisht nga legjislacioni i veçantë, për:

a) vendosjen në treg të produkteve biocide e të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
b) kërkesat minimale për sigurinë e shëndetin në punë dhe për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet që lidhen me ekspozimin ndaj agjentëve kimikë, si dhe substancave kancerogjene ose mutagjene në punë;

c) mjedisin, që përfshin legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit dhe për vlerat kufi të ndotjes së ajrit;

ç) menaxhimin e integruar të ujërave;

d) menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) substancat radioaktive, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkesat minimale për sigurinë e shëndetin në punë dhe për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet që lidhen me ekspozimin ndaj rrezatimit jonizues;

b) substancat, që janë subjekt i mbikëqyrjes doganore, të cilat, në formën e tyre të pastër, në një përzierje ose në një artikull, nuk i nënshtrohen ndonjë trajtimi ose përpunimi, por janë në ruajtje të përkohshme, në magazinat apo zonat e lira doganore, me qëllim rieksporimit apo transitimitin e tyre;

c) substancat e ndërmjetme të paizoluara;

ç) transportin e kimikateve të rrezikshme, si mallra të rrezikshme, përmes transportit hekurudhor, rrugor, transportit të brendshëm ujor, detar apo ajror, me përjashtim të kërkesave për paketim.

3. Dispozitat e parashikuara në kreun III, të këtij ligji, për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve nuk do të zbatohen për kimikatet që:

3.1. Vendosen në treg në formën e tyre përfundimtare si:

a) barna dhe pajisje mjekësore për përdorim human;

b) barna në veterinar;

- c) produkte kozmetike;
- ç) ushqime e lëndë shtesë në ushqime, si dhe si aromatizues;
- d) ushqime për kafshë dhe lëndë shtesë për këto ushqime.

3.2. Përdoren për studime dhe hulumtime shkencore, të cilat nuk vendosen në treg, por përdoren në mënyrë të kontrolluar, në përputhje me legjislacionin specifik për kushtet në mjediset e punës dhe mjedisin.

4. Dispozitat e parashikuara në kreun IV, të këtij ligji, për informimin në zinxhirin e furnizimit dhe në kreun VIII, lidhur me regjistrin e kimikateve, nuk do të zbatohen për kimikatet që vendosen në treg në formën e tyre përfundimtare, si:

- a) barna dhe pajisje mjekësore për përdorim human;
- b) barna në veterinari;
- c) produkte kozmetike;
- ç) ushqime e lëndë shtesë në ushqime, si dhe aromatizues;
- d) ushqime për kafshë dhe lëndë shtesë për këto ushqime.

5. Dispozitat e parashikuara në kreun IV, të këtij ligji, për vlerësimin e sigurisë së kimikateve dhe në kreun V, për substancat me rrezikshmëri shumë të lartë, nuk do të zbatohen kur kimikati përdoret në:

- a) barnat për përdorim human;
- b) barnat në veterinari;
- c) ushqimet dhe lëndët shtesë (p.sh. ëmbëlsuesit) në ushqime, si dhe aromatizuesit;
- ç) ushqimet për kafshë dhe lëndët shtesë për këto ushqime.

6. Dispozitat e parashikuara në kreun VI, të këtij ligji, për kufizimet nuk do të zbatohen për kimikatet:

- a) që prodhohen, vendosen në treg dhe përdoren për qëllime kërkimi e zhvillimi shkencor, me përjashtim të rastit kur kushtet për kufizimin e përcaktojnë ndryshe;
- b) substanca të ndërmjetme të izoluara në vend dhe substanca të ndërmjetme të izoluara që transportohen.

7. Dispozitat e parashikuara në kreun VII, të këtij ligji, për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme nuk do të zbatohen për:

- a) armët kimike dhe lëndët paraprirëse / perkursorët e armëve kimike;
- b) kimikatet që mund të përdoren për prodhimin e substancave narkotike e të substancave psikotrope;
- c) materialet radioaktive;
- ç) ushqimet dhe lëndët shtesë/aditivët në ushqime;
- d) ushqimet për kafshë dhe lëndët shtesë për këto ushqime;
- dh) barnat dhe pajisjet mjekësore për përdorim human;
- e) barnat në veterinari;
- ë) organizmat e modifikuar gjenetikisht;
- f) kimikatet që përdoren për studime dhe kërkime shkencore, të cilat nuk dëmtojnë mjedisin e shëndetin njerëzor dhe nuk do të kalojnë sasinë 10 kg për çdo kimikat, për çdo import.

8. Mbetja, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin specifik për menaxhimin e integruar të mbetjeve, nuk është një kimikat ose artikull, sipas kuptimit të këtij ligji.

Neni 5

Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. “Substancë” është një element kimik dhe komponimet e tij në gjendje natyrore ose të përfutuara nga çdo proces prodhimi, përfshirë çdo shtesë të nevojshme për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj, si dhe çdo papastërti që rrjedh nga procesi i përdorur, por duke përjashtuar çdo tretës që mund të ndahet pa ndikuar në qëndrueshmërinë e substancës apo ndryshimin e përbërjes së saj.

- 1.2. “Përzierje” është një përzierje ose tretësirë e përbërë nga dy ose më shumë substanca.
- 1.3. “Kimikat” është një substancë ose një përzierje substancash, e prodhuar ose e përftuar nga natyra, pa përfshirë organizmat e gjallë.
- 1.4. “Kimikate të rrezikshme” janë kimikatet, që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme të klasifikuara, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
- 1.5. “Artikull” është një objekt, të cilit gjatë prodhimit i është dhënë një formë, sipërfaqe ose dizajn i veçantë, i cili përcakton funksionin e tij në një shkallë më të madhe sesa vetë përbërja e tij kimike.
- 1.6. “Prodhim” është prodhimi ose nxjerrja e substancave në gjendje natyrore.
- 1.7. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili prodhon kimikate.
- 1.8. “Prodhues i një artikulli” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon ose monton një artikull.
- 1.9. “Substancë e njoftuar” është një substancë, për të cilën njoftimi është dorëzuar dhe e cila mund të vendoset në treg, në përputhje me legjislacionin specifik në fuqi.
- 1.10. “Import” është futja fizike e kimikateve në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.
- 1.11. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, përgjegjës për importin e tyre.
- 1.12. “Vendosje në treg” është importimi, furnizimi ose bërja e disponueshme e kimikateve në persona të tretë përkundrejt pagesës ose falas.
- 1.13. “Përdorim” është çdo përpunim, formulim, konsum, magazinim, trajtim, mbushje në kontejnerë, transferim nga një kontejner në një tjetër, përzierje, prodhim i një artikulli ose ndonjë mënyrë tjetër përdorimi të kimikateve.
- 1.14. “Kufizim” është çdo kushtëzim ose ndalim i prodhimit, përdorimit ose vendosjes në treg.
- 1.15. “Përdorues” (*downstream user*) është çdo person fizik ose juridik që, ndryshe nga prodhuesi apo importuesi, i shfrytëzon kimikatet për nevojat e tij apo për përgatitjet në kuadër të fushës së veprimtarisë së tij industriale ose profesionale. Shpërndarësi apo konsumatori nuk është përdorues.
- 1.16. “Furnizues i kimikateve” është çdo prodhues, importues apo shpërndarës që vendos kimikate në treg.
- 1.17. “Furnizues i një artikulli” është çdo prodhues ose importues i një artikulli, shpërndarës ose ndonjë operator tjetër në zinxhirin e furnizimit që vendos një artikull në treg.
- 1.18. “Marrës i një kimikati” është një përdorues ose një shpërndarës që furnizohet me një kimikat.
- 1.19. “Marrës i një artikulli” është një përdorues industrial ose profesional apo një shpërndarës, që furnizohet me një artikull, por nuk përfshin konsumatorët.
- 1.20. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, përfshirë një shitës me pakicë, i cili vetëm magazinon dhe vendos në treg një kimikat për palët e treta.
- 1.21. “Aktorët në zinxhirin e furnizimit” janë të gjithë prodhuesit dhe/ose importuesit dhe/ose përdoruesit tjetër në zinxhirin e furnizimit.
- 1.22. “Listë e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC)” është lista e substancave që, prej vetive të tyre të brendshme të rrezikshme, përbëjnë një rrezik serioz për jetën e shëndetin e njeriut dhe për mjedisin e, për këtë arsye, janë të ndaluara për t’u përdorur lirisht.
- 1.23. “Listë kandidate” është lista e substancave që janë duke u konsideruar/shqyrtuar për t’u bërë pjesë e listës SVHC.
- 1.24. “Konventë” është konventa e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit dhe pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare”, e ratifikuar me ligjin nr. 10 277, datë 13.5.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit”.

1.25. “Aliazh” është një material metalik, homogjen në një shkallë makroskopike, i përbërë nga dy ose më shumë elemente, nga të cilët të paktën njëri është metal, të kombinuar në mënyrë të tillë që nuk mund të ndahet lehtë me anë të mjeteve mekanike.

1.26. “Monomer” është një substancë, e cila është e aftë të lidhet në mënyrë të përsëritur me veten e vet, ose me substanca të ngjashme, me lidhje kovalente, nëpërmjet një reaksioni kimik që formon polimerin;

1.27. “Polimer” është një substancë makromolekulare, e ndërtuar nga lidhja e përsëritur e shumë substancave monomere. Masa molekulare e këtyre makromolekulave varet nga numri i njësisve monomere të lidhura në to. Një polimer përbëhet si më poshtë:

a) shumë e peshës së thjeshtë të molekulës që përmban të paktën tre njësi monomere, të cilat janë të lidhura me lidhje kovalente me të paktën me një njësi tjetër monomeri ose një reaktant tjetër;

b) më pak se shumë e peshës së thjeshtë të molekulës së të njëjtës peshë molekulare;

c) në kontekstin e këtij përkufizimi një “njësi monomeri” nënkupton formën e reaguesit të një substance monomere në një polimer.

1.28. “Substancë e ndërmjetme” është një substancë që është prodhuar dhe që konsumohet ose përdoret më tej për përpunime kimike, në mënyrë që të transformohet në një substancë tjetër;

i) Substancë e ndërmjetme e paizoluar është një substancë e ndërmjetme, e cila gjatë sintezës hiqet me qëllim (përveç marrjes së mostrave) nga pajisjet në të cilat ndodh sinteza. Pajisje të tilla përfshijnë enën e reaksionit, pajisjet e saj ndihmëse, si dhe çdo pajisje, përmes të cilës substanca/t kalon/jnë gjatë një rrjedhjeje të vazhdueshme ose procesi grumbullimi, si dhe tubacionet për transferimin nga një enë në një tjetër për qëllim të hapit tjetër të reaksionit, përjashtuar tanket apo enë të tjera, në të cilat substanca/t ruhet/n pas prodhimit;

ii) Substancë e ndërmjetme e izoluar në vend është një substancë të ndërmjetme që nuk përmbush kriteret e një substance të ndërmjetme të paizoluar dhe ku prodhimi i saj dhe sinteza e një ose disa substance/ve të tjera nga substanca e ndërmjetme zhvillohen në të njëjtin vend nga një ose më shumë persona juridikë;

iii) Ndërmjetës i izoluar i transportuar është një substancë ndërmjetëse që nuk përmbush kriteret e një substance ndërmjetëse të paizoluar, por që transportohet ose shpërndahet në vende të tjera.

1.29. “Kërkim dhe zhvillim shkencor” është çdo eksperiment shkencor, analiza apo kërkim kimik, i kryer në kushtet e kontrollit në një vëllim më pak se 1 ton në vit.

1.30. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Për qëllime të kreut VI për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme:

2.1. Termat e përdorur në kreun VI janë të njëjtë me përkufizimet e dhëna në konventë.

2.2. Termat e përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, do të zbatohen vetëm nëse këta terma nuk janë përkufizuar ndryshe në legjislacionin specifik për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme dhe në konventë.

KREU II AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE

Neni 6

Autoritetet kompetente

1. Ministria është autoriteti kompetent dhe në kuadër të këtij ligji krijohet Zyra e Kimikateve, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Zyra e Kimikateve krijohet si një institucion publik qendror, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe financohet nga Buxheti i Shtetit. Rregullat e organizimit e të funksionimit të Zyrës së Kimikateve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e Zyrës së Kimikateve miratohen nga Kryeministri.

3. Zyra e Kimikateve është përgjegjëse për:

a) përgatitjen e akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj;

- tij;
- b) mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave të nxjerra në zbatim të tij;
 - c) koordinimin ndërinstitucional lidhur me menaxhimin e kimikateve;
 - ç) bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me menaxhimin e kimikateve;
 - d) përgatitjen e procedurave, krijimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrisë Kombëtare të Kimikateve;
 - dh) publikimin e listës SVHC dhe listës së kandidatëve;
 - e) lëshimin e autorizimeve për përdorimin e mëtejshëm të listës SVHC;
 - ë) propozimin e heqjes së kimikateve nga tregu ose kufizimin e përdorimit të tyre kur përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
 - f) shërbimin e informacionit (*helpdesk*) për të ofruar këshilla për prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji;
 - g) informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për rreziqet që vijnë nga kimikatet kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit;
 - gj) plotësimin e detyrimeve lidhur me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për menaxhimin e kimikateve (Konventa e Stokholmit, Konventa e Roterdamit, protokollet e CLRTAP-it).

4. Ministria është Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e Konventës së Roterdamit dhe realizon procedurën e njoftimit për pëlqim paraprak dhe procedurën për marrjen e pëlqimit, në bazë të njoftimit paraprak për importin dhe eksportin e disa kimikateve të rrezikshme.

5. Ministria përgjegjëse për tregtinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë janë autoritetet kompetente për kontrollin në treg të kimikateve.

6. Ministria përgjegjëse për industrinë është autoriteti kompetent për licencimin e veprimtarive që lidhen me kimikate të klasifikuara si të rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë është përgjegjëse për marrjen e informacionit mbi sigurinë dhe rreziqet e kimikateve të rrezikshme për shëndetin, me qëllim hartimin e masave parandaluese kurative, veçanërisht për rastet e emergjencave shëndetësore.

Neni 7

Bashkëpunimi midis autoriteteve

1. Ministrinë, dogana dhe inspektoratet bashkëpunojnë midis tyre në kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas këtij ligji.

2. Për të mundësuar bashkëpunimin e institucioneve të përfshira në menaxhimin e kimikateve ngrihet një Komitet Ndërsektorial për Sigurinë Kimike (KNSK).

3. KNSK-ja vepron si një forum këshillues për koordinim në politika dhe në vendimmarrje, për shkëmbimin e informacionit dhe kontrollin e ndërsjellë, pa mandat për vendimmarrje detyruese.

4. Funksionet, përbërja, si dhe rregullat e procedurat për funksionimin e Komitetit Ndërsektorial për Sigurinë Kimike përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

KREU III

KLASIFIKIMI, ETIKETIMI DHE PAKETIMI

Neni 8

Detyrime të përgjithshme

1. Ndalohet vendosja në treg e kimikateve që nuk plotësojnë detyrimet e përcaktuara në këtë ligj e në aktet nënligjore, që dalin në zbatim të tij për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin.

2. Prodhuesit dhe importuesit e kimikateve janë të detyruar të klasifikojnë kimikatet përpara vendosjes së tyre në treg, në përputhje me dispozitat e vendimit, sipas pikës 6 të këtij neni.

3. Prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit janë të detyruar të etiketojnë dhe të paketojnë kimikatet, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë ligj, përpara vendosjes së tyre në treg, në mënyrë të tillë që substancat dhe përzierjet brenda paketimit të mos paraqesin rrezik për njeriun dhe mjedisin gjatë përdorimit, ruajtjes, magazinimit apo transportit.

4. Në paketimin e kimikateve të rrezikshme dhe të artikujve që nuk janë të rrezikshëm, por përmbajnë të paktën një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, duhet të përcaktohen emri tregtar i kimikatit, emri i substancës së rrezikshme që përmban përzierja, emri dhe adresa e furnizuesit të kimikatit, sasia e kimikatit që përmban ambalazhi, shenjat e rrezikshmërisë, si dhe teksti në të cilin përshkruhen vetitë e rrezikshme të kimikatit.

5. Përmbajtja e etiketës duhet të jetë në gjuhën shqipe.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton vendimin ku parashikohen rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve.

Neni 9

Lista e klasifikimit dhe etiketimit

1. Klasifikimi dhe etiketimi për substancat aktive në produktet e mbrojtjes së bimëve dhe produktet biocide, për substanca të caktuara kancerogjene, mutagjenike, substanca toksike për riprodhimin human, substanca sensitizuese për organet e frymëmarrjes dhe disa substanca të tjera të rrezikshme do të bëhen në përputhje me listën e klasifikimit e të etiketimit.

2. Klasifikimi dhe etiketimi i kimikateve, të cilat janë të listuara në listën e klasifikimit e të etiketimit, është i detyrueshëm të kryhet sipas kësaj liste.

3. Lista e klasifikimit dhe etiketimit, si dhe kriteret e veçanta për përfshirjen e substancave në këtë listë, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 6, të nenit 8, të këtij ligji.

4. Ministria publikon dhe përditëson listën e klasifikimit e të etiketimit, referuar në pikën 3, të këtij neni, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Komunikimi i rrezikut

1. Klasifikimi, paketimi dhe etiketimi përdoren për komunikimin e rrezikut që rrjedh nga kimikatet e rrezikshme dhe, si rezultat, edhe për menaxhimin e zvogëlimin e rrezikut nga këto kimikate.

2. Etiketa dhe Dokumenti i të Dhënave të Sigurisë për Kimikatet (MSDS) janë dy mjete të parashikuara për informim, që përdoren për të vënë në dukje rreziqet që vijnë nga përdorimi i kimikateve të rrezikshme.

3. Etiketa është i vetmi mjet i drejtpërdrejtë për informim dhe komunikim me konsumatorët, që shërben për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve dhe për t'i orientuar ata drejt informacionit gjithëpërfshirës për vetitë e substancave apo përzierjeve të caktuara.

Neni 11

Reklamimi

1. Ndalohet reklamimi i kimikateve që i përkasin një apo më shumë kategorive të specifikuar si të rrezikshme, nëse në to nuk paraqiten qartë kategoritë e rrezikut. Për çdo reklamim të një kimikati të klasifikuar si i rrezikshëm duhet të përmendet klasa e rrezikut ose kategoria e rrezikut që lidhet me të.

2. Për kimikatet që mund të blihen pa etiketë, të dhënat për vetitë e tyre të rrezikshme duhet paraprakisht të bëhen të ditura me shkrim, në një fletë të veçantë, në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të lexueshme.

3. Në reklamimin e kimikateve nuk duhet të fshihen rreziqet që ato mund të paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe nuk duhet të nxiten përdorimi, trajtimi ose asgjësimi i tyre në mënyrë të papërshtatshme.

4. Për çdo reklamim të një kimikati të klasifikuar si i rrezikshëm, në bazë të të cilit një pjesëtar i publikut të gjerë konkludon një kontratë blerjeje pa e parë më përpara etiketën e tij, duhet të përmendet klasa/klasat e rrezikut që tregohet/n në etiketë.

5. Terma të tillë, si “i degradueshëm”, “ekologjikisht i padëmshëm”, “miqësor për mjedisin” dhe “miqësor me ujin”, mund të përdoren në reklama vetëm nëse vetitë e përshkruara janë shpjeguar me hollësi.

6. Furnizuesit e kimikateve të rrezikshme ose të përzierjeve të klasifikuara si të parrezikshme, por që në përmbajtjen e tyre kanë të paktën një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, gjatë reklamimit duhet të tregojnë vetitë e rrezikshme të kimikateve. Gjatë reklamimit nuk lejohet fshehja e vetive të rrezikshme të kimikateve për përdoruesit dhe publikun.

7. Pika 1, e këtij neni, zbatohet pavarësisht nga legjislacioni i veçantë për mbrojtjen e konsumatorit, në respekt të kontratës në distancë midis një profesionisti dhe konsumatorit, e kryer nëpërmjet telefonit, e-mailit, katalogut etj.

KREU IV

VLERËSIMI I SIGURISË SË KIMIKATIT, DOKUMENTI ME TË DHËNAT E SIGURISË DHE KËRKESA TË TJERA PËR FURNIZUESIT

Neni 12

Kërkesa të përgjithshme për gjenerimin e informacionit mbi vetitë e brendshme të substancave

1. Gjenerimi i informacionit mbi vetitë e brendshme të substancave, me qëllim klasifikimin dhe vlerësimin e sigurisë së kimikateve, bazohet mbi të dhënat shkencore e teknike që janë në dispozicion dhe për të nuk kërkohet kryerja e testeve shtesë.

2. Opsioni i parë i gjenerimit të informacionit mbi vetitë e brendshme të substancave është kërkimi, shpërndarja dhe shkëmbimi i të dhënave mbi baza komerciale ose mënyra të tjera.

3. Çdo testim i ri eko-toksikologjik e toksikologjik, si dhe analizat kryhen në përputhje me:

a) parimet e praktikave më të mira laboratorike (GLP), sipas legjislacionit specifik;

b) standardeve të tjera ndërkombëtare të njohura si ekuivalente;

c) kërkesat për testime, sipas ndonjë legjislacioni tjetër specifik, nëse ka një të tillë.

4. Praktikave më të mira laboratorike dhe institucionet përgjegjëse për inspektimin e verifikimin e këtyre praktikave, si dhe për testimet e përcaktuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8, të këtij neni, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të ministrit përgjegjës për tregtinë në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrin përgjegjës për bujqësinë.

5. Testimet mbi kafshët kryhen vetëm në rastin kur, për qëllime të klasifikimit, alternativa të tjera nuk janë të mundshme. Testimet mbi kafshë kryhen në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e kafshëve që përdoren për eksperimente ose për qëllime të tjera shkencore. Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për bujqësinë miratojnë rregullat për mbrojtjen e kafshëve.

6. Testimet mbi kafshët vertebrorë, për qëllime të këtij ligji, kryhen vetëm në rastet kur nuk ka alternativa të tjera të testimit për klasifikimin e kimikateve në baza shkencore.

7. Testet mbi bletët, majmunët dhe primatët e tjerë jonjerëzorë janë të ndaluara, për qëllime të klasifikimit.

8. Ndalohen testimet në njerëz, për qëllime të klasifikimit të kimikateve, sipas këtij ligji. Për këtë qëllim mund të përdoren të dhënat e marra nga burime të tjera, të tilla si studime klinike.

Neni 13

Vlerësimi i sigurisë së kimikatit dhe masat e reduktimit të riskut

1. Vlerësimi i sigurisë së kimikatit është një procedurë që rezulton me Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë për Kimikatin, ku përfshihen rekomandimet për reduktimin e riskut dhe kontrollin e

duhur të efekteve të dëmshme nga substancat e rrezikshme.

2. Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi profesional i kimikateve, që kryejnë vlerësimin e sigurisë së kimikatit, duhet të përdorin metodat e përshkruara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Detyrimi për të mbajtur informacionin

1. Çdo prodhues dhe importues grumbullon dhe mban në dispozicion të gjithë informacionin që i kërkohet për zbatimin e detyrimeve, në kuadër të këtij ligji, për një periudhë të paktën 10-vjeçare, pasi ka prodhuar, importuar dhe furnizuar substancën ose përzierjen.

2. Furnizuesi grumbullon dhe mban në dispozicion të gjithë informacionin e përdorur për qëllime të klasifikimit e të etiketimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon klasifikimin dhe etiketimin, për një periudhë të paktën 10-vjeçare, pasi substanca ose përzierja është furnizuar për herë të fundit nga ai furnizues.

3. Në rast se një furnizues pushon aktivitetin ose ia transferon një pjesë apo të gjitha operacionet e tij një pale të tretë, pala përgjegjëse për likuidimin e ndërmarrjes së furnizuesit ose që merr përgjegjësinë për vendosjen në treg të substancës ose përzierjes në fjalë është e detyruar të plotësojë detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në vend të furnizuesit.

4. Ministria mund t'i kërkojë prodhuesit, importuesit ose furnizuesve të tjerë të dorëzojnë informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 15

Kërkesat për Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Kimikateve

1. Prodhuesi, importuesi dhe furnizues të tjerë të një kimikati i sigurojnë përdoruesit të kimikatit dokumentin me të dhënat e sigurisë kimike kur:

a) substanca plotëson kriteret për t'u klasifikuar si e rrezikshme, në përputhje me legjislacionin specifik për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve;

b) një substancë është e qëndrueshme, biologjikisht e akumulueshme dhe toksike ose shumë e qëndrueshme dhe shumë biologjikisht e akumulueshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës;

c) një substancë është e përfshirë në listën e kandidatëve, të miratuar sipas këtij ligji.

2. Dokumenti me të Dhënat e Sigurisë së Kimikateve duhet të jetë në gjuhën shqipe.

3. Prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi informojnë përdoruesin apo shpërndarësin për rreziqet që mund të shkaktojë një substancë ose përzierje dhe të japin informacion për trajtimin, ruajtjen dhe asgjësimin e sigurt të substancës apo përzierjes.

4. Prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi i kimikatit të rrezikshëm duhet të paraqesin falas për çdo shpërndarës apo përdorues të radhës dokumentin me të dhënat e sigurisë kimike, në letër apo në formë elektronike, që prej datës kur kimikati është vendosur në treg për herë të parë.

5. Kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë (SDS) përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 16

Detyrimi për komunikimin e informacionit mbi kimikatet në artikuj

1. Furnizuesi i një artikulli që përmban një substancë që përfshihet në listën e substancave me rrezikshmëri të lartë apo në listën e kandidatëve në një përqendrim mbi 0,1 për qind të peshës për peshë do t'i sigurojë marrësit të artikullit informacionin e mjaftueshëm që ai ka në dispozicion, për të lejuar përdorimin e sigurt të artikullit, duke përfshirë, minimalisht, emrin e asaj substance.

2. Me kërkesë të klientit/konsumatorit, çdo furnizues i një artikulli që përmban një substancë të përfshirë në listën SVCH ose listën e kandidatëve në një përqendrim më të lartë se 0,1 për qind të peshës për peshë (p/p) do t'i sigurojë konsumatorit informacionin e mjaftueshëm, që furnizuesi ka në

dispozicion, për të lejuar përdorimin e sigurt të artikullit, duke përfshirë, minimalisht, emrin kimik të asaj substance.

3. Informacioni përkatës sigurohet pa pagesë, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 17

Detyrimi për dhënien e informacionit mbi kimikatet në zinxhirin e furnizimit

1. Çdo aktor në zinxhirin e furnizimit të një kimikati do të japë informacionin e mëposhtëm tek aktorët e tjerë ose shpërndarësit e tjerë në zinxhirin e furnizimit:

- a) informacionin e ri mbi vetitë e rrezikshme, pavarësisht nga qëllimi i përdorimit;
- b) çdo informacion tjetër që mund të vërë në diskutim masat e duhura për menaxhimin e riskut, të identifikuara në Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë së Kimikateve, që i është dhënë atij, i cili komunikohet vetëm për përdorimet e identifikuara.

2. Shpërndarësit e shpërndajnë atë informacion tek aktorët e tjerë ose shpërndarësit e tjerë në zinxhirin furnizues.

Neni 18

E drejta e informimit të punëmarrësve

Punëdhënësit i sigurojnë punëmarrësve dhe përfaqësuesve të tyre aksesin në informacionin e dhënë, në përputhje me nenet 15 e 17, të këtij ligji, për kimikatet, ndaj të cilave punëmarrësit mund të jenë të ekspozuar gjatë procesit të punës.

KREU V

SUBSTANCAT ME RREZIKSHMËRI SHUMË TË LARTË (SVHC)

Neni 19

Zëvendësimi i substancës SVHC

Prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit profesionalë (*downstream users*) të një substance me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) analizojnë disponueshmërinë e alternativave më pak të rrezikshme dhe konsiderojnë mundësinë e zëvendësimit të substancave me rrezikshmëri shumë të lartë me substanca më pak të rrezikshme.

Neni 20

Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (në vijim lista SVHC)

1. Substancat, që i përkasin listës SVHC për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndalohen të vendosen në treg dhe të përdoren lirshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Në listën SVHC përfshihen substancat që u korrespondojnë rreziqeve të specifikuara në legjislacionin që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve, si:

- a) kategoritë kancerogjene 1A dhe 1B;
 - b) kategoritë mutagjene 1A dhe 1B;
 - c) substancat toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B.
3. Në listën SVHC përfshihen substancat që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- a) substancat që janë të qëndrueshme, të akumulueshme biologjikisht dhe toksike/helmuese (PBT);
 - b) substancat që janë shumë të qëndrueshme ose shumë të akumulueshme biologjikisht (vPvB).

4. Në listën SVHC përfshihen gjithashtu:

- a) substancat që mund të shkaktojnë çrregullime endokrine;
- b) substancat që nuk i plotësojnë kriteret e shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 3, por për të cilat ka të dhëna shkencore për efekte të mundshme serioze për njerëzit apo mjedisin, ekuivalente me substancat e listuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni.

5. Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e

substancave në listën SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar, me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

6. Autorizimi i kushtëzuar miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, pa përfshirjen e QKL-së.

Neni 21

Lista kandidatë

1. Substancat e rrezikshme, të cilat janë kandidatë për t'u futur në listën SVHC, përfshihen në listën kandidatë.

2. Lista e substancave kandidatë miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

KREU VI

KUFIZIMET MBI PRODHIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E DISA KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË RREZIKSHËM TË CAKTUAR

Neni 22

Dispozita të përgjithshme mbi kufizimet

1. Një substancë në formën e saj të pastër në një përzierje ose në një artikull, për të cilën ky ligj apo aktet nënligjore në zbatim të tij parashikojnë një kufizim, nuk do të prodhohet, nuk do të vendoset në treg apo nuk do të përdoret nëse nuk është në përputhje me atë kufizim.

2. Kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm të caktuar miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Për shkaqe teknike, sociale dhe ekonomike, bazuar në njoftimet e personave fizikë dhe juridikë që prodhojnë, importojnë, vendosin në treg një kimikat ose artikull, subjekt i kufizimeve, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë ngarkohen të rishikojnë kufizimet mbi prodhimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe eksportin e substancave të rrezikshme, grupet e substancave, substancat e përziera, substancat në lloje të caktuara të artikujve apo substancave në pajisje të caktuara, si edhe afatet kohore të parashikimit të hyrjes në fuqi të një kufizimi. Rishikimi i kufizimeve miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Një kimikat i rrezikshëm hiqet përkohësisht ose përfundimisht nga tregu, në rast se vërtetohet se paraqet rrezik të papranueshëm për shëndetin e njeriut apo mjedisin, edhe në qoftë se kimikati plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet që dalin në zbatim të këtij ligji.

Neni 23

Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes së mjedisit nga kimikatet

1. Në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga asbesti, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, përfshihen masa për reduktimin në burim të shkarkimeve të asbestit në ajër, të derdhjeve të asbestit në mjediset ujore dhe të mbetjeve të ngurta të asbestit.

2. Rregullat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Në reduktimin e ndotjes dhe eliminimin gradual deri në zhdukje të plotë të përdorimit të mërkurit përfshihen masat për ndalimin e eksporteve, reduktimin e mërkurit në produkte, procese dhe në industritë që e përdorin, çlirojnë ose shkarkojnë mërkur në atmosferë apo lëshojnë në mënyrë të pakontrolluar mbetjet teknologjike që përmbajnë mërkur, detyrimin për ruajtjen dhe asgjësimin e sigurt të mërkurit.

4. Rregullat e ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe kriteret specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

KREU VII

EKSPORTI DHE IMPORTI I SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME

Neni 24

Zbatimi i Konventës së Roterdamit

1. Objektivat, fusha e veprimit dhe procedurat e përgjithshme për njoftimin dhe pëlqimin paraprak të importit e të eksportit për disa kimikate e pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare (procedura PIC) jepen në ligjin që ka ratifikuar konventën.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton vendimin për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme. Ky vendim përcakton masat dhe procedurat administrative e ligjore që ndiqen në zbatim të neneve 10 e 11 të konventës.

3. Kimikatat dhe pesticidet që i nënshtrohen procedurës PIC, në bazë të konventës, ndalohen të eksportohen nga Republika e Shqipërisë, pa pasur pëlqimin eksplicit të dhënë nga vendi importues, palë në konventë, ose pa pasur informacionin, që në kushte të tjera përcakton se importi drejt vendit importues mund të ndodhë.

Neni 25

Njoftimi i eksportit të kimikateve dhe pesticideve me rrezikshmëri shumë të lartë që u nënshtrohen masave rregulatore dhe që nuk janë në Konventë

1. Këshilli i Ministrave, në vendimin për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme, të parashikuar në pikën 2, të nenit 24, të këtij ligji, përcakton gjithashtu:

a) listën e kimikateve, produkteve biocide dhe pesticideve që nuk janë pjesë e konventës, por që, për shkak të vetive të tyre të rrezikshme dhe risqeve që paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, i nënshtrohen procedurës së njoftimit të eksportit;

b) rregullat për procedurën e njoftimit të eksportit të kimikateve, produkteve biocide dhe pesticideve, të referuara në shkronjën “a” të kësaj pike.

2. Ndalohet eksporti nga Republika e Shqipërisë i kimikateve, produkteve biocide dhe pesticideve që i nënshtrohen procedurës së njoftimit të eksportit dhe për të cilat nuk zotërohet konfirmimi i marrjes së njoftimit nga vendi importues ose informacion tjetër shtesë i kërkuar nga pala importuese, që provon se importi drejt atij vendi mund të kryhet.

3. Ndalohet importi në Republikën e Shqipërisë i kimikateve, produkteve biocide dhe pesticideve të ndaluara ose të kufizuara në territorin e palës eksportuese, për të cilat Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar:

a) nuk ka marrë njoftimin e eksportit nga vendi eksportues;

b) nuk ka dhënë pëlqimin eksplicit të importit, kur pëlqimi eksplicit kërkohet në përputhje me legjislacionin specifik për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.

4. Eksportuesi i kimikateve është i detyruar të dërgojë në ministri informacionin me të dhënat që kërkohen nga organi kompetent i shtetit, nëpër territorin e të cilit bëhen eksporti dhe transiti i kimikateve që i nënshtrohen procedurës PIC, jo më vonë se 30 ditë para se të bëhet transiti.

5. Ministria informon organin kompetent të shtetit, nëpër territorin e të cilit bëhet transiti i kimikateve, jo më vonë se 15 ditë para se të bëhet transiti.

KREU VIII

DISPOZITA NË MBËSHTETJE TË MENAXHIMIT TË KIMIKATEVE

Neni 26

Plani për menaxhimin e sigurt të kimikateve

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton Planin Kombëtar për Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve.

2. Plani Kombëtar për Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve rishikohet në çdo 5 vjet.

Neni 27

Rregjistri i kimikateve

1. Çdo kimikat që prodhohet ose importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë regjistrohet në regjistrin elektronik të kimikateve.

2. Për qëllime të këtij ligji dhe akteve në zbatim të tij, ministria krijon dhe mirëmban regjistrin elektronik të kimikateve, në përputhje me standardet, rregullat, dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

3. Prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit profesionalë regjistrojnë kimikatet në regjistrin elektronik të kimikateve. Të dhënat mbi produktet e mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve biocide sigurohen nga autoritetet përgjegjëse që i regjistrojnë këto kimikate, në përputhje me legjislacionin për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe produkteve biocide.

4. Rregullat e detajuara për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, detyrimet për të raportuar në regjistrin elektronik të kimikateve, si dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 28

Licencimi i veprimtarive që lidhen me kimikatet e rrezikshme

1. Prodhimi, vendosja në treg, depozitimi dhe ruajtja e kimikateve të rrezikshme kryhen nga persona juridikë të pajisur me licencë.

2. Licenca për aktivitetet, sipas pikës 1, të këtij neni, u lëshohet/jepet personave juridikë nëse ata plotësojnë kushtet themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme:

a) kanë sistem mirëmbajtjeje dhe depozitimi të kimikateve të veçanta të rrezikshme;

b) sigurojnë parandalimin e aksesit/hyrjes së personave të paautorizuar që mund t'i përdorin kimikatet për qëllime jo të duhura;

c) ndërmarrin masa parandaluese për shmangien e rrezikut nga kimikatet e rrezikshme.

3. Me licencë pajisen edhe personat fizikë, që përdorin kimikate të rrezikshme për veprimtari të tilla, si: veprimtari artistike, veprimtari studimore shkencore dhe veprimtari të tjera specifike.

4. Licenca për prodhimin, vendosjen në treg, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme lëshohet nga ministri përgjegjës për industrinë.

5. Dokumentacioni dhe procedurat për dhënien e licencave për prodhimin, vendosjen në treg, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për industrinë.

6. Kimikate të rrezikshme, për të cilat lëshohet licenca, konsiderohen ato kimikate, të cilat, në klasifikimin dhe etiketimin e bërë në përputhje me legjislacionin që rregullon klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve, u përkasin klasave të mëposhtme të rrezikut:

a) klasës së rrezikut “Toksitet akut” në kategoritë e rrezikut 1, 2 dhe 3 dhe që etiketohen me piktogramën e rrezikut “Kafkë” dhe “Kryqëzimin e kockave” (SGH06) dhe shprehjen “Rrezik”;

b) një nga klasat e rrezikut “Kancerogjene, mutagjene për qelizat gjenetike ose toksike për riprodhimin” në kategoritë e rrezikut 1A ose 1B dhe që etiketohen me piktogramën e rrezikut “Rrezik për shëndetin” (SGH08) dhe shprehjen “Rrezik”;

c) klasës së rrezikut “Korrozive/Gërryese për lëkurën” në kategorinë e rrezikut 1A dhe që etiketohen me piktogramën e rrezikut “Korrozive /Gërryese” (SGH05) dhe shprehjen “Rrezik”;

ç) një nga klasat e rrezikut “Toksike për një organ të destinuar specifike-një ekspozim i vetëm ose toksike për një organ të destinuar specifike- ekspozim i përsëritur” në kategorinë e rrezikut 1 dhe që etiketohet me piktogramën e rrezikut “Rrezik për shëndetin” (SGH08) dhe shprehjen “Rrezik”.

Neni 29

Ruajtja, magazinimi dhe shitja e kimikateve të rrezikshme

1. Kushtet themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme janë:
 - a) zotërimi i një objekti të përgatitur për magazinimin e kimikateve;
 - b) sigurimi që në atë objekt të mos ketë akses për persona të paautorizuar;
 - c) pasja e kushteve për mbrojtjen fizike dhe mbrojtjen nga zjarri dhe, sipas nevojës, edhe kushteve të tjera parandaluese të rrezikut.
2. Kimikatet e rrezikshme duhet të mbahen dhe të ruhen mirë, në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktojnë. Në veçanti, duhet:
 - a) të mbrohen kundër ndikimeve të rrezikshme nga jashtë;
 - b) të jenë të mbrojtura dhe të paarrishme për palët e paautorizuara;
 - c) të mbahen ose të ruhen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndonjë rrezik, të mos shkaktohet konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime, ose për përdorimin gabimisht të tyre.
3. Kur kimikatet janë duke u ruajtur në magazina, duhet të merren parasysh këshillat dhe udhëzimet e dhëna në paketim dhe në Doku-mentin e të Dhënave të Sigurisë së Kimikateve.
4. Kimikatet e rrezikshme dhe paketimi i tyre duhet të mbrohen nga ndikimet e rrezikshme, veçanërisht nga ato të natyrës mekanike.
5. Kimikatet e rrezikshme duhet të jenë qartësisht të identifikueshme dhe gjatë ruajtjes në magazinë duhet të mbahen të ndara nga mallrat e tjera. Kimikatet duhet të mbahen vetëm në paketim origjinal, të mbyllur dhe të pathyeshëm.
6. Kimikatet e rrezikshme të vendosura në treg për t'u përdorur nga publiku mund të shiten në njësi të specializuara për kimikatet. Në rastet e shitjes me vetëshërbim, këto mallra nuk lejohen të ekspozohen në vende ku mund të merren lirisht; ato duhet të mbahen veç nga mallrat e tjera, në mënyrë që të shmangët kontakti me to dhe duhet të jepen vetëm nga shitësi.
7. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për industrinë, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, miraton udhëzues praktik për kushtet e ruajtjes dhe tregtimin me pakicë të kimikateve, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
8. Pikat 1 deri në 3 zbatohen edhe për objekte magazinimi, ku janë ruajtur kimikatet, në atë sasi që mund të rrezikojnë shëndetin e njeriut ose mjedisin, të cilat më pas janë vendosur në treg.
9. Kimikatet, të cilat mund të reagojnë me njëra-tjetrën duke shfaqur rrezik, duhet të ruhen në mënyrë të ndarë.
10. Kimikatet e rrezikshme duhet të ruhen në enë që plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - a) paketimi i kimikatit nuk duhet të ketë ngjashmëri apo të shkaktojë ngatërresë, për shkak të ngjashmërisë në paketim, me paketimin e produkteve ushqimore, kozmetike, produktet terapeutike ose ushqimin për kafshët;
 - b) emri i substancës apo i përzierjes duhet të jepet në etiketë;
 - c) paketimi duhet të jetë në përputhje me kreun III të këtij ligji.
11. Kimikatet, që plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar si mbetje, trajtohen sipas legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
12. Ndalohet shitja e kimikateve personave nën 18 vjeç si dhe vendosja në treg e përdorimi i kimikateve nga personat nën 18 vjeç.
13. Ndalohet shitja e kimikateve personave, të cilëve u është hequr ose u është kufizuar zotësia juridike për të vepruar.
14. Përdoruesit, që kryejnë veprimtari që lidhen me kimikate të rrezikshme, duhet:

a) t'i ruajnë këto kimikate nga vjedhjet, humbjet ose nga këmbimi me të tjera kimikate të rrezikshme;

b) të sigurojnë kërkesat minimale të sigurisë e të shëndetit në punë, në përputhje me kreun I, "Detyrimet e punëdhënësit", të ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 30

Nxjerrja jashtë përdorimit

Prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi mbledhin, ruajnë dhe nxjerrin jashtë përdorimit, në mënyrë të sigurt, mbetjet e kimikateve të rrezikshme dhe paketimet e tyre, në përputhje me legjislacionin mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 31

Raporti vjetor për kimikatat

1. Ministria harton raportin vjetor për gjendjen e kimikateve.
2. Raporti për kimikatat, sipas pikës 1, të këtij neni, është pjesë e Raportit për Gjendjen e Mjedisit.
3. Raporti, sipas pikës 2, të këtij neni, përmban kryesisht: shënimet për llojet e kimikateve, shënimet për lejet e lëshuara për kimikatat që prodhohen, importohen, eksportohen, shënimet për hulumtimet e kryera për kimikatat, shënimet për laboratorët e akredituar dhe realizimin e planit të veprimit për menaxhimin e kimikateve.

Neni 32

Sistemi informues për kimikatat

1. Shkëmbimi i informacioneve me institucionet ndërkombëtare për kimikatat bëhet duke u bazuar në dispozitat e dokumenteve të ratifikuara nga organi kompetent i Republikës së Shqipërisë.
2. Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shkëmbimi i informacioneve me institucionet vendore për kimikatat është detyrë e ministrisë, duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji lidhur me detyrimet për informim mbi kimikatat.
3. Ministria informon publikun dhe autoritetet përkatëse nëpërmjet faqes zyrtare të ministrisë për rreziqet që mund të rrjedhin nga përdorimi i substancave dhe përzierjeve të rrezikshme dhe rekomandon marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e rrezikut.

KREU IX

RAPORTIMI, AKSESI PËR INFORMACION DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 33

Organet për marrjen e informacionit posaçërisht për përgjigje në raste emergjence shëndetësore

1. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së është organi përgjegjës për marrjen e informacionit përkatës nga importuesit dhe përdoruesit / përdoruesit profesionalë që vendosin në treg përzierjet, me qëllim hartimin/përgatitjen e masave parandaluese dhe kurative, veçanërisht në

rastet e përgjigjeve të emergjencave shëndetësore. Ky informacion është pjesë përbërëse e dokumentacionit për aplikimin për regjistrim dhe përfshin përbërjen kimike të përzierjeve që janë vendosur në treg dhe të klasifikuara si të rrezikshme, në bazë të efekteve të tyre shëndetësore ose fizike. Informacioni për sigurinë kimike, që kërkohet nga prodhuesit e importuesit e kimikateve dhe procedurat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 4, të nenit 27, të këtij ligji. Instituti i Shëndetit Publik ka akses në këto të dhëna, për qëllime të vlerësimit të riskut dhe ndikimit në shëndet ose të rekomandimit të masave për parandalimin e helmimeve.

2. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së përgatit protokollat e trajtimit emergjent në rast të helmimeve nga kimikatet e rrezikshme. Instituti i Shëndetit Publik dhe Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së rekomandojnë masat e duhura për parandalimin e rreziqeve nga helmimi.

3. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së dhe Instituti i Shëndetit Publik ofrojnë të gjitha garancitë/masat e duhura për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të marrë. Një informacion i tillë mund të përdoret vetëm:

a) për të plotësuar kërkesat mjekësore lidhur me formulimin e masave parandaluese e mjekësore, veçanërisht në rast emergjence;

b) kur kërkohet nga ministria dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë për të ndërmarrë analiza statistikore për identifikimin se kur mund të nevojiten masa për përmirësimin e menaxhimit të rrezikut.

Informacioni nuk përdoret për qëllime të tjera.

4. Instituti i Shëndetit Publik dhe Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së kanë akses në të dhënat e regjistrimit të kimikateve, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna të tjera të nevojshme drejtpërdrejt nga prodhuesi ose importuesi i kimikateve të rrezikshme, me qëllim sigurimin e ndonjë informacioni shtesë për substancat dhe përzierjet e rrezikshme.

5. Informacioni që kërkohet nga prodhuesit dhe importuesit e kimikateve, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, si dhe rregullat e shkëmbimit të informacionit mes ministrisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe Shërbimit të Toksikologjisë Klinike të QSUT-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

6. Pranë Shërbimit të Toksikologjisë Klinike të QSUT-së krijohet Qendra 24/24 për informim në rast helmimesh.

7. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton rregullat për funksionimin e qendrës për informacion në rast helmimesh, informacionet që shkëmbehen dhe rregullat e shkëmbimit të informacionit mes Institutit të Shëndetit Publik dhe kësaj qendre.

Neni 34

Bashkëpunimi me shtetet e treta dhe organizatat ndërkombëtare

Informacioni i siguruar nga ministria, në kuadër të këtij ligji, mund t'i vihet në dispozicion një vendi të tretë apo një organizatë ndërkombëtare, bazuar në një marrëveshje të nënshkruar me ta, me qëllim që të plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

a) qëllimi i marrëveshjes është bashkëpunimi për zbatimin e legjislacionit në lidhje me kimikate të trajtuara sipas këtij ligji;

b) pala e tretë ruan/mbron informacionin konfidencial siç është rënë dakord nga të dyja palët.

KREU X

INSPEKTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 35

Inspektimi dhe mbikëqyrja

1. Inspektimi i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, lidhur me detyrimet që kanë prodhuesit dhe importuesit e kimikateve, kryhet nga inspektorati shtetëror që mbulon mjedisin, i cili:

a) kontrollon nëse kimikatet dhe artikuj të caktuar përpara vendosjes në treg janë të klasifikuar, etiketuar dhe paketuar në përputhje me këtë ligj dhe vendimet e dala në zbatim të tij;

b) kontrollon nëse prodhuesit dhe importuesit kanë plotësuar detyrimet për regjistrimin e kimikateve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij;

c) kontrollon nëse prodhuesit dhe importuesit kanë plotësuar detyrimet për njoftimin e kimikateve të kufizuara ose të ndaluara për t'u prodhuar, hedhur në treg dhe përdorur, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij;

ç) kontrollon nëse prodhuesit dhe importuesit zbatojnë detyrimet e autorizimit të kushtëzuar për përdorim të mëtejshëm të SVHC-ve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij;

d) kontrollon nëse janë plotësuar detyrimet sipas dispozitave ligjore mbi përmbajtjen e Dokumentit të të Dhënave të Sigurisë së Kimikateve;

dh) kontrollon përpara se të bëhet importi/eksporti i kimikateve të rrezikshme nëse zbatohen procedurat e informimit për pëlqim paraprak dhe informimi bëhet në kohën e duhur;

e) kontrollon mbajtjen e informacionit nga prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit, të përshkruar sipas këtij ligji, si dhe nëse informacioni ruhet sipas afatit të caktuar;

ë) kontrollon nëse informimi dhe raportimet për kimikatet e rrezikshme është i saktë dhe është bërë në kohë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Inspektorati shtetëror nën ministrinë përgjegjëse për tregtinë, është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të kimikateve të rrezikshme dhe artikujve të caktuar, që kanë në përbërje të tyre të paktën një substancë të rrezikshme, që shiten nga shpërndarësit për konsum të përgjithshëm, lidhur me kontrollin nëse:

a) janë të etiketuara dhe të paketuara, sipas kërkesave të këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij;

b) janë të pajisura me Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë së Kimikateve, sipas kërkesave të këtij ligji dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij.

3. Inspektorati shtetëror nën ministrinë përgjegjëse për industrinë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e pajisjes me licencë të personave fizikë/juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit, vendosjes në treg, depozitimit e ruajtjes së kimikateve të rrezikshme dhe zbatimin e kushteve të saj.

4. Inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin, inspektorati shtetëror përgjegjës për tregtinë dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë paraqesin raportin vjetor të inspektimeve pranë Zyrës së Kimikateve brenda datës 1 mars të vitit pasardhës.

Neni 36

Autoriteti doganor

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

a) kontrollon importin dhe eksportin e kimikateve, për të cilat eksporti ose vendosja në treg janë të kufizuara, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) monitoron importuesit dhe eksportuesit lidhur me zbatimin e dispozitave mbi njoftimin e eksportit dhe konfirmimit të marrjes së njoftimit të eksportit ose marrjes së pëlqimit eksplicit të importit, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të ligjit nr. 10 277, datë 13.5.2010, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit".

Neni 37

Sigurimi i qasjes së lirë për inspektorin

1. Personat fizikë dhe juridikë, që kryejnë veprimtari tregtare, janë të detyruar që inspektorit:

a) t'i mundësojnë inspektim dhe qasje të lirë për marrjen e të dhënave të duhura për inspektimin;

b) t'i krijojnë qasje, me qëllim kryerjen e detyrës së inspektimit, kontrollimit të hapësirës, objektit, aparaturave, pajisjeve dhe dokumentacionit;

c) t'i lejojnë marrjen e mostrave për të vërtetuar se kimikati i plotëson kushtet, sipas dispozitave të këtij ligji, për vendosje në treg.

2. Shpenzimet për ekzaminimet e vetive të substancave e të përzierjeve kompensohen nga prodhuesi, importuesi ose furnizuesi tjetër i kimikateve, vetëm në rastet kur rezultatet e testimit nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 38

Kontrolli i importit, eksportit dhe transitit të kimikateve

1. Përpara çlirimit për qarkullim të lirë (vendosjes në treg) të kimikatit të rrezikshëm, autoritetet doganore verifikojnë dokumentacionin shoqërues të kimikateve të rrezikshme, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Dogana përkohësisht ndalon zbatimin e procedurave të mëtejshme doganore, të kërkuara me qëllim çlirimin për qarkullim të lirë të kimikatit në treg, nëse gjatë kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, vërtetohet se kimikatet e rrezikshme:

a) nuk shoqërohen nga dokumentacioni përkatës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) nuk janë etiketuar e paketuar sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Nëse autoritetet doganore konstatojnë se lista e dokumentacionit të kërkuar për të shoqëruar kimikatet e rrezikshme nuk është e plotë apo këto mallra nuk janë etiketuar e paketuar, sipas dispozitave të këtij ligji, ato bllokojnë mallin dhe njoftojnë Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit.

4. Në procesin e kontrollit të kimikateve të rrezikshme, inspektori i mjedisit është i autorizuar të vendosë:

a) ndalimin e importimit të kimikateve të rrezikshme, vendosja në treg e të cilave nuk është e lejuar në Republikën e Shqipërisë, duke urdhëruar kthimin te dërguesi;

b) ndalimin e kalimit transit të kimikateve të rrezikshme, paketimi apo etiketimi i të cilave nuk është në përputhje me dispozitat e aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, duke urdhëruar që kimikatet e rrezikshme të kthehen te dërguesi;

c) zbatimin e masave të tjera për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit gjatë importit, eksportit e transitit të kimikateve.

Neni 39

Detyrimi për të siguruar përputhshmërinë

Gjatë kryerjes së detyrave të referuara në nenin 35, të këtij ligji, inspektori i mjedisit, inspektori përgjegjës për tregtinë dhe inspektori përgjegjës për industrinë, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, kanë të drejtë që në bazë të një vendimi:

a) të urdhërojnë që kimikatet e vendosura në treg të klasifikohen, të etiketohen dhe të paketohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të dala në zbatim të këtij ligji;

b) të ndalojnë vendosjen në treg të kimikateve të klasifikuara, të etiketuara dhe të paketuara në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e akteve të nxjerra në zbatim të tij dhe:

i) të urdhërojnë tërheqjen nga tregu të kimikateve ose artikujve të caktuar të klasifikuar, të etiketuar, të paketuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

ii) të urdhërojnë prodhuesit, importuesit ose furnizuesit të njoftojnë konsumatorët ose përdoruesit profesionalë për rrezikun që paraqesin këto kimikate ose artikuj të caktuar;

c) të ndalojnë reklamimin e kimikateve të rrezikshme e të artikujve të caktuar që nuk janë të rrezikshëm, por përmbajnë të paktën një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, që është kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe vendimet e dala në zbatim të tij;

ç) të urdhërojnë mbajtjen e informacionit të përcaktuar për vlerësimin e sigurisë së kimikateve dhe ruajtjen e tij, sipas afatit të caktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

d) të urdhërojnë përmbushjen e detyrimeve ligjore nga furnizuesit e kimikateve dhe artikujve për vënien në dispozicion të dokumentacionit me të dhënat e sigurisë për kimikatet në të gjithë zinxhirin e furnizimit;

dh) të ndalojnë vendosjen në treg të kimikateve të rrezikshme, të cilësuar si substanca të kufizuara dhe të përzierjeve, të cilat përmbajnë substanca të ndaluara;

e) të urdhërojnë magazinimin e kimikateve të rrezikshme në mënyrë të sigurt dhe ruajtjen e trajtimit e mbetjeve e të paketimeve boshe të kimikateve, sipas legjislacionit specifik për mbetjet e rrezikshme;

ë) të ndalojnë magazinimin e kimikateve të rrezikshme e të mbetjeve të tyre, si dhe të paketimeve boshe, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

f) të ndalojnë shitjen e kimikateve të vendosura në treg si mall i konsumit për përdorim të gjerë, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

g) të ndalojnë punën e prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit që ushtron aktivitet pa licencë, sipas kërkesave të këtij ligji;

gj) të urdhërojnë që të raportohet, sipas afatit të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për kimikatet që gjenden (janë të regjistruara) në regjistrin e kimikateve;

h) të ndalojnë prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

i) të ndalojnë prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji për ndalimet e kufizimet;

j) të urdhërojnë tërheqjen e kimikateve nga tregu, për të cilat nuk janë zbatuar ndalimet dhe kufizimet, sipas këtij ligji;

k) të urdhërojnë që para eksportit të kimikateve të jepet informacioni i caktuar në kohë, sipas dispozitave të këtij ligji për procedurën e informimit paraprak;

l) të urdhërojnë që të bëhet kërkesa për zbatimin e procedurës PIC;

ll) të ndalojnë vendosjen në treg të kimikateve shumë të rrezikshme nga personat që nuk posedojnë autorizimin e kushtëzuar;

m) të urdhërojnë që për kimikatet shumë të rrezikshme të sigurohet magazinimi i sigurt e të krijohen kushte dhe të zbatohen masat parandaluese, të caktuara me këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

n) të ndalojnë prodhimin, vendosjen në treg, përdorimin e kimikateve të rrezikshme dhe, sipas nevojës, të urdhërojnë shkatërrimin e tyre, nëse konstatohen se edhe në rastin e përdorimit në mënyrë të duhur, kimikatet mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

nj) të urdhërojnë ose, kur është e nevojshme, të organizojnë me prodhuesit, importuesit, shpërndarësit dhe autoritetet kompetente tërheqjen mbrapsht të substancave, përzierjeve dhe artikujve, nëse ato menaxhohen në kundërshtim me ndalimet e kufizimet, duke përfshirë zbatimin e masës së tërheqjes mbrapsht të substancës, përzierjeve dhe artikujve, si dhe shkatërrimin e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe me shpenzimet e importuesit, prodhuesit, p.sh. shpërndarësit të sigurojnë që substancat, përzierjet dhe artikujt, të cilët nuk janë menaxhuar në përputhje me ndalimet dhe kufizimet, të kthehen në vendin e origjinës ose të menaxhohen në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme;

o) të urdhërojnë masa tjera, për të cilat janë të autorizuar me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU XI KUNDËRVAJTJET

Neni 40

Kundërvajtjet dhe sanksionet

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Prodhimi, vendosja në treg apo përdorimi i kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm, të caktuar në kundërshtim me kufizimet, sipas nenit 22, të këtij ligji, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dënohet me gjobë në vlerën:

- a) 300 000 deri në 500 000 lekë për përdoruesin;
- b) 500 000 deri në 1 000 000 lekë për furnizuesin;
- c) 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë për prodhuesin apo importuesin.

2. Prodhimi, vendosja në treg apo përdorimi i një kimikati të rrezikshëm nga persona nën moshën 18 vjeç, në kundërshtim me pikën 12, të nenit 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

3. Prodhimi, vendosja në treg e kimikateve të rrezikshme të paklasifikuara, të papaketuara dhe të paetiketuara, në kundërshtim me nenin 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

4. Prodhimi, vendosja në treg e kimikateve të rrezikshme, në kundërshtim me rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve, të përcaktuara sipas pikës 6, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën:

a) 500 000 deri në 1 000 000 lekë, kur kimikatet nuk janë të klasifikuara në mënyrën e duhur, në përputhje me rregullat e detajuara në legjislacionin specifik;

b) 100 000 deri në 300 000 lekë, kur kimikatet nuk janë të paketuara në mënyrën e duhur (p.sh. paketimi i të cilave nuk siguron mbylljen e shtrëngueshme, si dhe nuk përmban shenjat e prekshme për të mbrojtur fëmijët dhe të verbrit), në përputhje me rregullat e detajuara në legjislacionin specifik;

c) 100 000 deri në 300 000 lekë, kur kimikatet nuk janë të etiketuara në mënyrën e duhur, në përputhje me rregullat e detajuara në legjislacionin specifik;

ç) 500 000 deri në 1 000 000 lekë, kur etiketa e kimikatit nuk është në gjuhën shqipe.

5. Reklamimi i kimikateve që i takojnë një apo më shumë kategorive të specifikuara si të rrezikshme, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

6. Tregtimi i kimikateve pa etiketë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 800 000 lekë.

7. Reklamimi i kimikateve duke fshehur rreziqet që ato mund të paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, në kundërshtim me përcaktimin e pikave 3 dhe 6, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 800 000 lekë.

8. Reklamimi i kimikateve që sjell përshtypje të gabuar, lidhur me rreziqet që ato paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin ose për pranueshmërinë e tyre mjedisore dhe, për pasojë, nxitja e përdorimit, trajtimit ose asgjësimit të tyre në mënyrë të papërshtatshme, në kundërshtim me pikat 3 dhe 4, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

9. Reklamimi i kimikateve të rrezikshme në kundërshtim me përcaktimin e pikës 4, të nenit 11, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 800 000 lekë.

10. Kryerja nga prodhuesi dhe importuesi i vlerësimit të sigurisë së kimikateve nëpërmjet kryerjes së testeve shtesë, pa u bazuar mbi të dhënat shkencore e teknike në dispozicion, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 1, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

11. Zhvillimi i testeve të kimikateve të rrezikshme nga prodhuesit, të cilat janë të ndaluara të kryhen në qenie shtazore, në kundërshtim me përcaktimet në pikat 5 e 6, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

12. Zhvillimi i testeve të kimikateve të rrezikshme, të cilat janë të ndaluara të kryhen në njerëz, bletët, majmunët dhe primatët e tjerë jonjerëzorë, në kundërshtim me përcaktimet në pikat 7 e 8, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 700 000 deri në 1 500 000 lekë.

13. Kryerja e çdo testimi të ri eko-toksikologjik dhe toksikologjik në mospërputhje me parimet e GLP-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare, në kundërshtim me përcaktimet në pikat 3 e 4, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

14. Moszbatimi i kushteve për GLP-së nga laboratorët që kryejnë testimin, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

15. Vlerësimi i sigurisë së kimikateve nga prodhuesi e importuesi, në kundërshtim me rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, sipas përcaktimit në nenin 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

16. Mospërmbushja e kërkesave nga prodhuesi e importuesi për grumbullimin dhe mbajtjen në dispozicion të të gjithë informacionit për një periudhë të paktën 10-vjeçare, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

17. Mospërmbushja e kërkesave nga furnizuesi për grumbullimin dhe mbajtjen në dispozicion të të gjithë informacionit për një periudhë të paktën 10-vjeçare, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

18. Mospërmbushja e kërkesave nga pala përgjegjëse për vendosjen në treg të substancës ose përzierjes, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

19. Mospërmbushja e kërkesave nga prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi për dhënien e informacionit të kërkuar nga ministria, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

20. Mossigurimi i Dokumentit me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet për përdoruesit nga prodhuesi, importuesi dhe furnizuesi, sipas përcaktimit të pikave 1 e 5, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën:

a) 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë për furnizuesit;

b) 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë për prodhuesit dhe importuesit.

21. Mosparaqitja e dokumentit me të dhënat e sigurisë për kimikatet në gjuhën shqipe, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 100 000 deri në 300 000 lekë.

22. Mosdhënia e informacionit nga prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit për përdoruesin apo shpërndarësin lidhur me rreziqet që mund të shkaktojë një substancë ose përzierje, si dhe informacionit për trajtimin, ruajtjen dhe asgjësimin e sigurt të kimikatit në kundërshtim me pikën 3, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë.

23. Mosdhënia falas e dokumentit me të dhënat e sigurisë kimike nga prodhuesit, importuesit dhe furnizuesit për përdoruesin apo shpërndarësin, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 15, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë.

24. Mossigurimi nga furnizuesit i një artikulli të informacionit të mjaftueshëm për përdoruesit dhe konsumatorët, që lejon përdorimin e sigurt të artikullit, sipas përcaktimit të pikave 1 e 2, të nenit 16, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 100 000 deri në 300 000 lekë.

25. Mosdhënia e informacionit për kimikatet e rrezikshme nga çdo aktor në zinxhirin e furnizimit të një kimikati, sipas përmbajtjes së specifikuar në nenin 17, të këtij ligji, gjatë furnizimit të palëve të treta, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

26. Mossigurimi nga punëdhënësit të informacionit mbi kimikatet e rrezikshme për punëtorët e ekspozuar gjatë procesit të punës, sipas përcaktimit të nenit 18, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 100 000 deri në 300 000 lekë.

27. Prodhimi, vendosja në treg apo përdorimi i një substance që gjendet në listën SVHC, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 18, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 10 000 000 lekë.

28. Mospajisja me autorizim të kushtëzuar për prodhimin, vendosjen në treg apo përdorimin e në vazhdim të një substance që gjendet në Listën e Substancave me Rrezikshmëri të Lartë SVHC, sipas përcaktimeve në pikën 6, të nenit 18, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 10 000 000 lekë.

29. Kryerja e importit dhe eksportit të kimikateve, produkteve biocide dhe pesticideve në kundërshtim me rregullat për procedurën e njoftimit të eksportit, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

30. Mosdërgimi në afat në ministri nga eksportuesit dhe importuesit e kimikateve ose përzierjeve i të dhënave për sasinë e eksportuara e të importuara të kimikateve dhe përzierjeve të caktuara për shtetet, nga të cilat janë importuar ose eksportuar, si dhe i shënimeve për eksportuesin dhe importuesin e kimikateve, në kundërshtim me nenin 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

31. Mosraportimi në afat në ministri nga eksportuesi i kimikateve dhe përzierjeve, për nevojat e organit kompetent të shtetit, nëpër territorin e të cilit zhvillohet eksporti dhe transiti i substancave dhe përzierjeve kimike, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

32. Importimi dhe eksportimi i substancave dhe përzierjeve, përdorimi i të cilave është i ndaluar, me qëllim për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 25, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 3 000 000 lekë.

33. Mosregjistrimi i kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 27, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 600 000 lekë.

34. Mosraportimi në ministri nga prodhuesi, importuesi, eksportuesi brenda datës 31 mars të vitit vijues për sasinë e prodhuar, të importuar, të eksportuar të kimikateve për vitin e kaluar, në kundërshtim me pikat 1 dhe 4, të nenit 27, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

35. Prodhimi, vendosja në treg, përdorimi, depozitimi, ruajtja e kimikateve të rrezikshme nga persona të papajisur me licencë, në kundërshtim me nenin 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

36. Shkelja e kushteve të licencës së kimikateve nga ana e poseduesit të saj, në kundërshtim me nenin 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

37. Shkarkimet e asbestit në ajër ose derdhjet e tij në mjedis, në kundërshtim me vlerat kufi të parashikuara në legjislacionin specifik, në përputhje me këtë ligj, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

38. Kryerja e eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, në kundërshtim me rregullat e ndalimit, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

39. Ruajtja e merkurit metalik në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

40. Ruajtja e merkurit metalik të konsideruar si në kundërshtim me kriteret specifike të ruajtjes, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë.

41. Mospërbushja e kushteve themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme në një objekt të përgatitur për magazinimin e kimikateve, në kundërshtim me nenin 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

42. Mosmbajtja dhe mosruajtja mirë e substancave dhe e përzierjeve të rrezikshme, në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktohet nga ndikimet e jashtme nga palët e paautorizuara apo që mund të shkaktojë konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime, në kundërshtim me nenin 29, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

43. Mosidentifikimi në mënyrë të qartë i substancave dhe i përzierjeve të rrezikshme gjatë ruajtjes në magazinë, si dhe mosmbajtja e tyre të ndara nga mallrat e tjera, në kundërshtim me nenin 29, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

44. Ruajtja e substancave dhe e përzierjeve të rrezikshme, të cilat janë të furnizuara, në enë ose paketime që shkaktojnë konfuzion te konsumatori për shkak të ngjashmërisë me paketimet e produkteve ushqimore, kozmetike, produkteve terapeutike ose ushqimin e kafshëve, në kundërshtim me nenin 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shkarkon subjektin, drejt të cilit ajo është lëshuar, nga detyrimet e tjera të parashikuara në këtë ligj dhe nga përgjegjësia civile për dëmet e shkaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 41

Ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative

1. Ekzekutimi i masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.

2. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Të ardhurat nga vjelja e gjobave dhe të ardhura të tjera, të mbledhura në përputhje me dispozitat e këtij ligji, derdhen në masën 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XII

DETYRIMET FINANCIARE

Neni 42

Tarifat

1. Në zbatim të këtij ligji, prodhuesi, importuesi, eksportuesi e përdoruesi profesional paguan tarifën përkatëse për:

a) futjen e një kimikati në regjistrin e kimikateve;

b) kërkesën për autorizim importi;

c) njoftimin e importit;

ç) kërkesën për autorizim eksporti;

d) kërkesën për autorizim të kushtëzuar për përdorim të listës SVHC;

dh) njoftimin e përdorimit të emrit kimik alternativ të substancës së rrezikshme;

e) njoftimin e eksportit;

ë) njoftimin për shtyrjen e afateve kohore të hyrjes në fuqi për çdo kufizim të kimikateve të rrezikshme.

2. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përcaktohen tarifa të reduktuara.

3. Tarifat e përcaktuara sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, paguhen në ministri.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat miraton vlerat përkatëse të tarifave të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dhe procedurat për zbatimin e tyre.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 6, pika 2; 8, pika 6; 9, pika 3; 12, pika 4; 13, pika 3; 15, pika 5; 20, pikat 5 dhe 6; 21, pika 2; 22, pikat 2 dhe 3; 23, pikat 2 dhe 4; 24, pika 2; 26, pika 1; 27, pika 4; 28, pika 5; 33, pikat 1 dhe 5, dhe 42, pika 4, të nxjerrë, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 44
Shfuqizime

Me fillimin e efekteve juridike të këtij ligji, aktet e mëposhtme shfuqizohen:

- a) ligji nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimikate”, i ndryshuar;
- b) vendimi nr. 824, datë 12.9.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Përfundimisht, detyrimet për klasifikimin, etiketimin, paketimin e kimikateve dhe dokumentacionin me të dhënat e sigurisë, të përcaktuara në kreun III, të këtij ligji, hyjnë në fuqi:

- a) për substancat që vendosen në treg ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë, më 1 korrik 2018;
- b) për përzierjet që vendosen në treg ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë, më 1 korrik 2020.

Miraturar në datën 17.3.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9479, datë 24.3.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**